



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 24.8.2023

Nr: 727

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**“PËRCAKTIMIN E VLERËS NË PARA TË NJË VOTE TË VLEFSHME, PËR ZGJEDHJET PËR
ORGANET E QEVERISJES VENDORE, TË DATËS 14 MAJ 2023”**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n” dhe 2, nenit 88, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar si dhe të vendimit nr. 27, datë 7.8.2023, të Komisionit Rregullator, “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023”,

VËREJ:

Neni 88, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikon se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga nxjerrja e rezultatit përfundimtar në shkallë vendi, përcakton me vendim vlerën në para të 1 (një) vote të vlefshme, duke pjesëtuar fondin e përgjithshëm të miratuar, me numrin e përgjithshëm të votave të vlefshme të grumbulluara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje, që kanë marrë jo më pak se 1 përqind të votave të vlefshme në shkallë vendi. Për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, llogaritja bëhet mbi bazën e votave të marra për këshillat vendorë në shkallë vendi.

Referuar lidhjes nr. 2, të vendimit nr. 27, datë 7.8.2023, të Komisionit Rregullator, “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj

Data: 24.8.2023 Nr: 727
Ora: 12:00



“Për përcaktimin e vlerës në para të një vote të vlefshme, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023”

2023”, partitë që kanë përfituar jo më pak se 1 përqind të votave dhe votat e vlefshme të grumbulluara prej tyre, janë si më poshtë:

| | | |
|---------------------------------------------------|--------------|--------|
| 1. Partia Socialiste e Shqipërisë (PS) | 579.625 vota | 43.11% |
| 2. Bashkë Fitojmë (BF) | 247.883 vota | 18.44% |
| 3. Partia Demokratike (PDSH) | 103.723 vota | 7.71% |
| 4. Partia Socialdemokrate (PSD) | 86.283 vota | 6.42% |
| 5. Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë (PAA) | 44.047 vota | 3.28% |
| 6. Partia Republikane Shqiptare (PR) | 32.071 vota | 2.39% |
| 7. Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet (PDIU) | 28.978 vota | 2.16% |
| 8. Partia Lëvizja e Legalitetit (PLL) | 23.683 vota | 1.76% |
| 9. Aleanca Progresiste L.ZH.K (LZHK) | 22.906 vota | 1.70% |
| 10. Partia Demokracia Sociale (P.D.S) | 21.798 vota | 1.62% |
| 11. Fryma e Re Demokratike (FRD) | 18.459 vota | 1.37% |
| 12. Aleanca Liberale e Djathtë (ALD) | 16.859 vota | 1.25% |
| 13. Partia e Gjelbër (P.GJ) | 16.326 vota | 1.21% |

Gjithsej vota të vlefshme

1.242.641 vota

Fondi i vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit për financimin e fushatës zgjedhore të partive politike pjesëmarrëse në zgjedhjet e datës 14 Maj 2023, referuar vendimit nr. 30/2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për miratimin e fondit për financimin e partive pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2023”, ishte 100.00.000 (njëqind milion) lekë.

Referuar nenit 88, pika 2, të Kodit Zgjedhor, pjesëtimi i fondit të përgjithshëm të miratuar me numrin në total të votave të vlefshme të grumbulluara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje, që kanë marrë jo më pak se 1 përqind të votave të vlefshme në shkallë vendi sjell si rezultat vlerën në para të 1 (një) vote të vlefshme 100.000.000 (njëqind milion) lekë / 1.242.641 (një milion e dyqind e dyzet e dy mijë e gjashtëqind e dyzet e një) vota = 80.47 (tetëdhjetë e dyzet e shtatë) lekë.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n” dhe 2, nenin 88, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar si dhe vendimin nr. 27, datë 7.8.2023, të Komisionit Rregullator, “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023”,

V E N D O S:

1. Vlera në para e një vote të vlefshme është 80.47 (tetëdhjetë e dyzet e shtatë) lekë.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI